



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 64, datë 16.06.2022

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.77, DATË 28.06.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 3, 5, 7, RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR. 1, RRUGA “DEMOKRACIA” PALLATI NR. 2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR.6, RRUGA “MILENIUMI” DHE PALLATI NR. 4, RRUGA “MINIERËS” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË Z.ADEM KACULI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.77, datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për Pallatin nr. 3, 5, 7, Rruga “Bashkimi”, Pallati nr. 1, Rruga “Demokracia”, Pallati nr. 2/1, Rruga “Progresit”,

Pallati nr. 6, Rruga "Mileniumi" dhe Pallati nr. 4, Rruga "Minierës" në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së bashkisë "Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5", si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtesë në Aneksin nr. 1, Pallati nr. 5, Rruga "Bashkimi", të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 28.06.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 3, 5, 7, Rruga "Bashkimi", Pallati nr. 1, Rruga "Demokracia", Pallati nr. 2/1, Rruga "Progresit", Pallati nr. 6, Rruga "Mileniumi" dhe Pallati nr. 4, Rruga "Minierës" në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 28.06.2021, si përfitues të z. Adem Kaculi, në masën e strukturës së njësisë së banimit 1+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 17.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 504 / prot.
3

Durrës, më _____, 2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.64 datë 16.06.2022 Për miratimin e një shtese në aneksin nr 1 të VKB Nr 77 dt 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 3,5,7,Rr.”Bashkimi”, Pall. Nr 1 Rr.”Demokracia”, Pall nr 2/1 Rr“Progresit”, Pall nr 6 Rr “Milenium” dhe Pall nr 4 Rr”Minierës” në njësinë administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, duke përfshirë Z.Adem Kaculi.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

